

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN E MBIKQYRJES
FINANCIARE ME OBJEKT “ MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT
EKONOMIK DHE FINANCIAR PËR PERIUDHËN 01.01.2013 deri më 30.09.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar”, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 34, datë 31.03.2015.

Bazuar në nenet 10,15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr1034/7 dt: 31/03/2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar z.Enkeleda Shehi, Drejtore AMF-sw.

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.Nga auditimi i të ardhurave që realizohen dhe që i shërbejnë aktivitetit bazuar në nenin 26 “Financimi dhe buxheti” të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, ku specifikohet se “*Autoriteti është institucion i pavarur, që kryesisht financohet nga burimet e veta por, për çdo diferencë ndërmjet burimeve të fondeve dhe shpenzimeve të veprimtarisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes financohet nga Buxheti i Shtetit deri në çastin kur të ardhurat janë të mjaftueshme për të siguruar funksionimin normal të tij. Pjesa e financimit nga Buxheti i Shtetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si pjesë e pavarur e Buxhetit të Shtetit. Teprica e buxhetit për vitin financiar kalon në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar, me përjashtim të fondeve të destinuara për investimet, të cilat janë në proces...*”, konstatojmë që nga viti 2010, institucioni nuk ka marrë fonde nga buxheti i shtetit për mbarëvajtjen e tij dhe është financuar tërësisht nga të ardhurat e realizuara vetë. Të ardhurat e krijuara nga kontributet e shoqërive të sigurimit janë në referencë të rregullores “*Mbi masën e kontributit vjetor të shoqërive të sigurimit*”, dhe në fund të vitit u njihet shoqërive të sigurimit si parapagim për vitin pas ardhës diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të funksionimit të AMF-së, pas zbritjes së shpenzimeve të destinuara për investime në proces. Në bazë të Vendimit të Bordit nr. 42, datë 24.04.2013 “*Për masën e parapagimit të kontributit vjetor për shoqëritë e sigurimit për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2013*”, është njohur për vitin 2014 **shuma prej 29,336,958 lekë**, ndërsa në bazë të Vendimit të Bordit nr. 61, datë 24.04.2014 “*Mbi masën e parapagimit të subjekteve të mbikëqyra për vitin 2014*”, është njohur **25,850,439 lekë**, si parapagim për këtë vit. Nisur nga ky konstatim, por dhe faktit që ky institucion tenton me të drejtë një pavarësi të plotë financiare, kërkesë që e konsiderojmë plotësisht të bazuar në referencë të misionit të rëndësishëm që institucioni ka, trajtuar në faqet 43-44 të Raportit të Auditimit, ***për këtë është rekomanduar:***

Nga bordi ndryshimi i ligjit nr.54, datë 29.05.2014, ku në nenin 27 “Përcaktimi i tarifave për subjektet e mbikëqyrura”, pika 3, cilësohet se “... *Kur fondi i rezervës është në nivelin e përcaktuar në shkronjën “c”, të nenit 26 të këtij ligji, çdo tepricë që mbetet nga të*

ardhurat vjetore të Autoritetit njihet dhe regjistrohet si paradhënie e subjekteve të mbikëqyrura për periudhën pasardhëse, duke e shpërndarë në mënyrë përpjesëtimore me kontributin e tyre”, i cili plotëson hapësirën midis përcaktimeve të nenit 26 të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe nenit 27 ku citohet se “Ankimi i vendimit të Bordit nuk e pezullon ekzekutimin e tij. Pagesat, nëse vlerësohen të tepërta, i kthehen subjektit të mbikëqyrur”, duhet të lexohet me kujdes dhe duke e harmonizuar me kërkesën për hartimin e pasqyrave financiare bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit gjykojmë si të domosdoshme që rezultati financiar të kalojë në fondet e veta ose në buxhetin e shtetit, si një element i rëndësishëm që do të ndikojë në rritjen e përgjegjshmërisë institucionale në administrimin e fondeve në dispozicion.

Në vijimësi

2. Nga auditimi rezultoi se, në bazë të vendimit të Bordit të AMF nr. 108, datë 30.10.2013 “Për miratimin e krijimit të planit të pensionit profesional për punonjësit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, mbështetur në nenin 53 të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, por pa një mbështetje nga ligji organik i AMF-së, institucioni për periudhën e audituar, ka përfshirë stafin e tij në planin e pensionit profesional dhe ka derdhur dhe kontribute për pensionin vullnetar që përbëhet nga pagesa e punëdhënësit në masën 8% dhe të punëmarrësit që varion në masën 2% deri 5%. Shuma e kontributit punëdhënësit dhe punëmarrës për vitin 2013, është 4,193,633 lekë dhe për 9-mujorin e vitit 2014, është 3,801,320 lekë. Për vitin 2013, nga 41 punonjës që kanë derdhur kontribut për pension vullnetar, 14 prej tyre, kanë derdhur në masë 5%, kurse 27 punonjës, në masën 2% ndërsa, për 9-mujorin e vitit 2014, kanë derdhur kontribute për pension vullnetar, gjithsej 44 punonjës, nga të cilët 15 prej tyre, kanë derdhur në masën 5%, kurse 29 punonjës në masën 2%, trajtuar në faqet 24 të Raportit të Auditimit, ***për këtë është rekomanduar:***

Një politikë të kujdesshme dhe të mirëpërcaktuar për mënyrën e krijimit, % e kontributeve të cilat asnjëherë nuk duhet të tejkalojnë masën e kontributeve të detyrueshme të paguara për çdo punonjës si dhe mënyrën e administrimit të këtij fondi duke qenë të kujdesshëm për të eliminuar risqet e konfliktit të interesit.

Menjëherë

3. Nga auditimi mbi të ardhurat u konstatua se në periudhën e auditimit gjobat e pambledhura ishin në shumën 5,500,000 lekë, që përfaqëson vlerën e gjobave të vendosura nga AMF-ja, gjatë periudhës 2006-2012 për 6 shoqëri sigurimi dhe 3 individë. Ndërsa, gjendja e këtyre detyrimeve në fund të auditimit arriti në shumën 1,700,000 lekë. Për arkëtimin e gjobave institucioni vazhdimisht i është drejtuar zyrtarisht shoqërive të sigurimit duke i kërkuar ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga sanksionet në fjalë, në një kohë që mund ta zbriste detyrimin për shumën e gjobave të vëna shoqërive të sigurimit, nga shuma e parapagimit të njohur për vitin e ardhshëm. Në referencë të ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, i cili u shfuqizua me ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, 80% e gjobës derdhej në buxhetin e shtetit, ***për këtë është rekomanduar:***

Nga ana e autoritetit, të ndiqet në vijimësi arkëtimi i sanksioneve të vëna gjatë monitorimit të tregjeve duke siguruar në këtë mënyrë edhe forcimin e rolit mbikëqyrës në tregjet financiarë në vend.

Në vijimësi

4. Megjithëse pasqyrat financiare të entitetit janë certifikuar nga një ekspert kontabël i pavarur, i cili ka dhënë një opinion të pakualifikuar, nga auditimi u konstatuan disa pasaktësi në kontabilizimin dhe paraqitjen e të ardhurave të shtyra si dhe mungesë të informacionit shpjegues në lidhje me lëvizjet e aktivet e trupëzuara të cilat ishin material për vitin 2013. Nga ana tjetër duke qenë se, institucioni zbaton rregullat e një institucioni buxhetor, amortizimi nuk përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve por rregullohet tek vlera e fondeve në dispozicion. Kjo tregon se megjithëse është një entitet i pavarur që mbahet me fondet e veta, kontabiliteti nuk reflekton këtë situatë, ***për këtë është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Sektori i Administrimit Financiare të marrë masat e duhura për hartimin e pasqyrave të kujdesshme financiare bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit duke reflektuar statusin e një autoriteti të pavarur financiar si dhe të synohet drejt certifikimit të pasqyrave financiare nga ekspertë kontabël me eksperiencë ndërkombëtare dhe të familjarizuar me institucione financiare dhe trajtimet kontabël të aktivitetit të tyre.

Në vijimësi

5. Për vitin 2013, njësia ka funksionuar dhe është organizuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 98, datë 30.04.2007 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”. Struktura ofron vija të qarta të përgjegjësive dhe të kalimit të informacionit, që lejon monitorimin e veprimtarisë së institucionit nga drejtuesi apo, menaxherët dhe e ndihmon drejtuesin në vendimmarrje, por struktura nuk përputhet me kërkesat e vendimit të KM nr. 474, datë 16.06.2011 “Për përcaktimin e standardeve të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, pasi, në strukturën e miratuar ka drejtori, apo sektorë që nuk përputhen me kërkesat e vendimit të mësipërm sipas pikës 20 ku citohet: “*Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës*” dhe pikës 21 ku citohet: “*Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë të drejtuar nga një shef ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës*”. Kështu, Sektori i Modelimeve Financiare, Sektori i Letrave me Vlerë, Sektori i Monitorimit, Sektori i Çështjeve Ligjore, Sektori i Hartimit të Akteve, Sektori i Mbrojtjes së Investitorëve, kanë në përbërje të tyre vetëm 1 specialist. Gjithashtu, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 4 punonjës, 1 drejtor dhe 3 specialistë, Drejtoria e IT, ka gjithsej 2 punonjës një drejtor dhe 1 specialist, Drejtoria e Rregullimit dhe Standardeve ka gjithsej 3 punonjës, 1 drejtor dhe 2 specialistë, Drejtoria Juridike ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 3 punonjës 1 drejtor dhe 2 specialistë, Drejtoria e Zbatueshmërisë ka 2 sektorë pa shef, gjithsej 4 punonjës, 1 drejtor

dhe 3 specialistë. Struktura e Auditimit të Brendshëm ka 1 punonjës me emërtimin inspektor, në bazë të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, duhet të emërtohet auditues.

Njësia për ndryshimin e strukturës organike nr. 98, datë 30.04.2007, gjatë viteve 2008-2011, ka dërguar për miratim në Kuvend ndryshimet përkatëse por, deri tani Kuvendi nuk ka miratuar ndryshimin e strukturës pasi, me të drejtë pas marrjes së opinionit nga Departamenti i Administratës Publike, ka bërë vërejtjet e tij. Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre por, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kap. II “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, **për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të bërë ndryshimin e strukturës organike, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me akte administrative të brendshme, të përcaktojë delegimin e kompetencave apo, të detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Deri më 30.06.2015.

6. Nga auditimi rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka kryer shpenzime të panevojshme për pritje e përcjellje, etj **në shumën 1,055,700 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 36, ku citohet: *“Dokumenti quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin,...”*, **për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masa të menjëhershme që, në kushtet e një institucioni të pavarur të hartojë rregulla të qarta dhe mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve të natyrës së përgjithshme në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” duke synuar gjithmonë minimizimin e angazhimeve financiare të panevojshme.

Në vijimësi.

7. Nga auditimi rezultoi se, për riparimin e mjeteve, nuk janë bërë hyrje në magazinë pjesët e ndërrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Kreu II “Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrime”, neni 6 “Evidencat mbështetëse”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 dhe Udhëzimin i Ministrisë së

Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, **për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura që, për të gjithë rastet e riparimit të automjeteve, të bëjë hyrje në magazinë pjesët e këmbimit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Në vijimësi.

8. Në bazë të ligjit dhe manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik, për vitet 2013-2014, struktura e Auditimit të Brendshëm ka hartuar planet vjetore të auditimit dhe mbi bazën e tyre ka realizuar auditimet. Për kryerjen e auditimeve në zbatim të manualit të auditimit, janë hartuar programet e auditimit për çdo subjekt të audituar. Programi i Auditimit përmban objektin, strukturën që do të auditohet, afatin e auditimit, periudhën e auditimit, etj., por, kjo strukturë në planet e auditimit nuk ka përcaktuar vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi, kërkesa këto të parashikuara në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, **për këtë është rekomanduar:**

Struktura e Auditimit të Brendshëm të marrë masa që, në të ardhmen në programet e auditimit të përcaktojë dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve si, mjedisi i kontrollit, menaxhimit i riskut, aktivitetet e kontrollit, informacioni dhe komunikimi dhe monitorimi.

Në vijimësi.

9. Në tenderin me objekt “*Blerje karburanti*” për vitin 2013, rezultoi se, nga Autoriteti Kontraktor, para pagimit të faturës së mallit, nuk është bërë kontrolli i përqindjes së rritjes apo, të uljes së çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, si dhe cilësinë e karburantit, nëse është e njëjtë me atë të deklaruar nga operatori ekonomik në ofertën e tij, parashikuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik, **për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat që para pagimit të faturës së mallit për blerjen e karburantit, të bëhet kontrolli i përqindjes së rritjes apo, të uljes së çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, si dhe cilësinë e karburantit, nëse është e njëjtë me atë të deklaruar nga operatori ekonomik në ofertën e tij, parashikuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik, Kreu VIII “Ekzekutimi i Kontratës”, pika 2, germa c.

Në vijimësi.

10. Nga auditimi rezultoi se, zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit, nuk ka siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të

përzgjedhjes së fituesit. Mos kryerja e këtij veprimi bie ndesh me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, ku cilësohet se: *“Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit ... Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për zyrtarin e autorizuar prej Titullarit të Autoritetit Kontraktor, kryhen në respektim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, për këtë është rekomanduar:*

Zyrtari i autorizuar, për fillimin e prokurimit të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve, të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit, në respekt të sigurimit të një përgjegjshmërie më të lartë në administrimin e këtij procesi

Në vijimësi.

11. Raportet përmbledhëse të vlerësimit të procedurave të prokurimeve, që u janë dërguar për miratim Titullarit të Autoritetit Kontraktor, pas përfundimit të afateve të ankimit për çdo tender të zhvilluar, janë nënshkruar vetëm nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në një kohë që, duhej të ishin nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO-së. Një kërkesë e tillë është parashikuar në VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, ***për këtë është rekomanduar:***

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit për çdo tender të zhvilluar, të hartojnë procesverbalin përmbledhës i cili të nënshkruhet prej tyre.

Në vijimësi.

12. Nga auditimi rezultoi se, një pjesë e dokumentacionit ligjor në tenderin e zhvilluar me objekt *“Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit AMF in-Reg Management System”*, të paraqitur nga operatori “Vizor Limited” (si i vetmi operator ekonomik që ofron këtë shërbim në treg), ishte i shkruar në gjuhën anglisht pa u përkthyer në gjuhën shqipe, siç është përcaktuar në Ftesën për Ofertë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, trajtuar në faqen 32 të Raportit të Auditimit, ***për këtë është rekomanduar:***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, të marrë masat që në ardhmen, çdo dokument që administrohet në dosjen e një procedure prokurimi, dhe që është në gjuhë të huaj, duhet të përkthehet në gjuhën shqipe për të mundësuar jo vetëm auditimin e plotë të kësaj kontrate por dhe të sigurohet një transparencë më e lartë lidhur me këtë kontratë me vlerë të konsiderueshme.

Në vijimësi.

13. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2013, për dosjet e tenderëve me dokumentet ligjore-administrative, është kryer inventarizimi vetëm me emërtimin e dokumenteve ligjore, sasitë me numrin dhe kopjet e fletëve përbërëse dhe nuk është bërë numërimi i

fletëve dhe numri në total i tyre. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 “Inventari i brendshëm i dosjes”, modeli nr. 8 dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” **për këtë është rekomanduar:**

Pas përfundimit të procedurave të tenderimit, Njësia e Prokurimit të marrë masa për inventarizimin e dosjeve të prokurimit sipas modelit nr. 8, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”. Arkivimi i dosjeve të bëhet në përputhje me numrin rendor të objektit të prokurimit.

Në vijimësi.

14. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa a, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Sektorit Publik”, njësia për periudhën objekt auditimi, nuk ka hartuar dhe miratuar planin strategjik i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, **për këtë është rekomanduar:**

Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar, planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo vit, i cili të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Deri më 30.06.2015

15. Konstatuam se struktura e Auditimit të Brendshëm ka konstatuar gjetje në **shumën 426 mijë lekë**, nga të cilët 421 mijë lekë, janë si rezultat i mosmbajtjes së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi 252 mijë lekë dhe punëmarrësi 169 mijë lekë, për raportet mjekësore deri në 14 ditë dhe 5 mijë lekë, si rezultat i mosmbajtjes së tatimit mbi të ardhurat personale për këto raporte. Gjetja është konstatuar me të drejtë por nuk është lënë rekomandim për derdhjen e shumës së mësipërme për skemën e sigurimeve shoqërore, por vetëm korrigjimin në të ardhmen, **për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të marrë masat e duhura për mbajtjen dhe derdhjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në **shumën 421 mijë lekë**, për raportet mjekësore deri në 14 ditë, dhe **shumën 5 mijë lekë** për tatimit mbi të ardhura.

Menjëherë.

16. Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu I “Dispozita të Përgjithshme”, neni 4 “Përkufizime”, nëpunësi autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset që menaxhohen prej tyre ndërsa, nëpunësi zbatues

është nëpunësi i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë. Me gjithë kërkesën e grupit të auditimit, nuk n'a u paraqit asnjë shkresë për caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues, në kundërshtim me ligjin e mësipërm, ***për këtë është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masat e duhura, për të caktuar nëpunësin autorizues që është përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxheteve të tyre, si dhe të caktojë nëpunësin zbatues, koordinatorin e riskut dhe grupin e menaxhimit strategjik (GSM) i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

Menjëherë.

17. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2013, njësia ka organizuar trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve kryesisht në fushën e tregut të sigurimeve, siç është bashkëpunimi me Bankën Botërore për trajnimin “Aspekte Aktuariale të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në Shqipëri”, trajnim i cili mundësoi prezantimin e metodave të reja në llogaritjen e primit të riskut në kontratat e sigurimit të detyrueshëm. Gjithashtu, njësia ka organizuar dhe trajnimin online për programin “FSI Connect”, për thellimin e njohurive të punonjësve në drejtim të mbikëqyrjes në fushën e sigurimeve por, të pamjaftueshme nëse nuk kombinohen me plane të qarta institucionale për trajnimin e vijueshëm të kapaciteteve njerëzore që ka institucioni, ***për këtë është rekomanduar:***

Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni të hartojë dhe miratojë programe specifike për ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore që ka në dispozicion sidomos në fushat specifike të monitorimit të tregut financiar.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, punonjësit të trajnohen dhe në kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualit të dalë në zbatim të tij, pasi konstatuam se drejtuesit nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e njësisë.

Të punohet për ngritjen e një sistemi informacioni që mbledh dhe dokumenton nevojat e çdo punonjësi për trajnim dhe nivelin e trajnimeve, të realizuara gjatë një viti dhe ta bëjë këtë indikator pjesë të vlerësimit periodik të punës së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi.

18. Pas planifikimit të fondeve, institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve financiarë por, në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i

riskut”, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe për pasojë, drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut , ***për këtë është rekomanduar:***

Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Menjëherë.

19. Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj., ***për këtë është rekomanduar:***

Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Deri më 31.06.2015.

20. Njësia, për vitin 2013, ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm por, nuk ka dërguar një kopje në Ministrinë e Financave, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Për këtë qëllim Ministria e Financave me shkresën nr. 19618/214, datë 26.03.2013, i ka tërhequr vëmendjen njësisë për mosdërgimin e deklaratës dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2012. Në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Financave njësia me datë 15.05.2013, dërgon në ministri deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2012, si dhe pyetësin e vetëvlerësimit. Gjithashtu, për vitin 2013, njësia ka hartuar pyetësin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së por, nuk ka dërguar një kopje në Ministrinë e Financave, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ***për këtë është rekomanduar:***

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të marrë masa e duhura që, në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për veprimtarinë gjatë vitit të mëparshëm për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësin e vetëvlerësimit, me qëllim që të ndihmojë njësinë, në identifikimin e atyre aspekteve të kontrollit të brendshëm, ku nevojitet të ndërmerret ndërgjegjësim i mëtijshëm dhe ku duhet të adresohen nevojat për trajnim.

Në vijimësi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Nga auditimi rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka kryer *shpenzime për trajnime* për punonjësit e tij, kështu në bazë të Vendimit të Bordit nr. 178, datë 13.12.2011, janë kryer shpenzime të *pambështetura në dispozita ligjore*, për mbështetjen financiare të punonjësës **znj. [REDAKTUAR]**, për kryerjen e studimeve pasuniversitare (2 vjet) në Universitetin “[REDAKTUAR]”, në masën 90% të tarifës së shkollimit, në shumën 2,950 euro, gjithsej për të dy vitet 2012-2013, janë paguar **5,850 Euro, për këtë është rekomanduar:**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, të ndjekë procedurat ligjore për të kërkuar shpërblimin **për shumën 5,850 Euro, nga znj. [REDAKTUAR]**, për sa paguar për kryerjen e studimeve pasuniversitare (2 vjet) në Universitetin “[REDAKTUAR]”, në masën 90% të tarifës së shkollimit, shpenzime të cilat janë kryer jo në mbështetje të dispozitave ligjore.

Menjëherë.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT